



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1506 Prot

Tiranë, më 12.10.2020

NJOFTIM

Lënda: Shpallje për vende vakante për oficer të policisë gjyqësore.

Në zbatim të nenit 38, pika 2, gërma “dh” dhe “e”, të Ligjit nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, dhe neneve 17 dhe 18, të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, Vendimit nr. 23, datë 10.06.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për Caktimin e Rregullave për Organizimin e Procedurës së Konkurimit dhe Emërimit të Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Prokurorisë””, shpall vendet vakante si më poshtë:

1. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Vlorë** 3(tre) vende.
2. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Korçë** 2(dy) vende.
3. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Krujë** 1(një) vend.
4. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Dibër** 1 (një) vend.
5. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Shkodër** 2 (dy) vende
6. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Berat** 2 (dy) vend.
7. Oficer të policisë gjyqësore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë **Gjirokastrë** 2 (dy) vende.

➤ ***Aplikantët që do të shprehin interesin duhet të dorëzojnë dokumentat e mëposhtëm;***

- a) Kërkesën për t'u emëruar oficer i policisë gjyqësore në seksionin e Policisë Gjyqësore, ku është shpallur vendi vakant,
- b) Jetëshkrimin e detajuar të kandidatit,
- c) Kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas ligjislacionit në fuqi për arsimin e lartë,
- d) Librezën e punës ose çdo dokument tjetër që vërteton përvojën në punë të kandidatit si jurist në institucionet publike, private ose profesionet e lira ose në fushën e specialitetit të kërkuar ose si oficer i policisë gjyqësore në shërbimet e policisë gjyqësore.(mbi 5 vjet)
- e) Vlerësime të mëparshme të punës,
- f) Dëshmi të gjuhëve të huaja dhe dëshmi të trajnimeve që ka kryer (nëqoftë se ka),
- g) Dëshmi penaliteti që tregon se kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që vërtetojnë se nuk është në ndjekje penale apo gjykim për kryerjen e ndonjë vepre penale.

h) Dokument që vërteton se ndaj kandidatit nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore dhe se në momentin e konkurimit nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj tij

➤ **Konkurimi zhvillohet në dy etapa:**

Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Sektori i Burimeve Njerëzore, kandidatët e kualifikuar, i nënshtrohen vlerësimit nëpërmjet testimit profesional. Vlerësimi i kandidatëve nëpërmjet testimit profesional kalon në tre faza nëpërmjet një procesi pikëzimi dhe përfshin:

- a) Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;
- b) Faza e dytë, Vlerësimi me shkrim ;
- c) Faza e tretë, Intervista e strukturuar me gojë

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë kërkesat sëbashku me dokumentacionin që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të përcaktuar në ligj, brenda **15 ditëve**, nga data e shpalljes së njoftimit në adresën: **Prokuroria e Përgjithshme, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1 Tiranë.**

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇEJA

